



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbajtur, më 07.02.2020)*

***Pika 1 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për komandimin e përkohshëm si Inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të magistrates znj. Marsela Pepi”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:11 dhe mbaroi në orën 13:44.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi*** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 7. Ilir Toska*** (anëtar)
- 8. Alban Toro*** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj*** (anëtar)
- 10. Erjon Muharremaj*** (anëtar)
- 11. Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
5. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
6. *Gregor Borgowski, EURALIUS.*
7. *Anisa Kuçi, EURALIUS.*
8. *Valbona Bala, USAID.*
9. *Erion Fejzulla, USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për komandimin e përkohshëm si Inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të magjstrates znj. Marsela Pepi”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Naureda Llagami:* Përshëndetje!

Siç jeni në dijeni, po fillojmë mbledhjen e radhës të datës 07.02.2020.

Në rend të ditës janë 2 çështje.

Çështja e parë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për komandimin e përkohshëm si Inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të magjstrates znj. Marsela Pepi”.

Çështja e dytë është shqyrtimi i projektvendimit “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”.

Atëherë, kalojmë me çështjen e parë, e cila do të relatohet nga zoti Toska.

*Ilir Toska:* Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur një projektvendim “Për komandimin e përkohshëm si Inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të

magjistrates znj. Marsela Pepi”. Lidhur me këtë projektvendim, po ju parashtroj në mënyrë të shkurtër rrethanat që çuan Komisionin në përgatitjen e këtij projektvendimi.

Me vendimin nr.2/2020, datë 20.01.2020, Kuvendi i Republikës ka zgjedhur z.Artur Metani si Inspektor të Lartë të Drejtësisë. Nisur nga kjo, bazuar në nenin 283, pika 8, të ligjit “Për organet qe qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, sipas të cilit “Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do të konsiderohet e krijuar ditën e parë të muajit që vjen pas emërimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nga Kuvendi”, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë konsiderohet e krijuar nga data 01.02.2020.

Me rastin e krijimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për ta bërë menjëherë funksional këtë institucion të drejtësisë, në nenin 283, pika 10, të ligjit “Për organet qe qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, është parashikuar se: “Në ditën e krijimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndër të tjera, inspektorët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të cilët janë magjistratë, ... do të konsiderohen si inspektorë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për një periudhë 6-mujore nga data e krijimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë. ...”.

Po kështu, edhe në nenin 168, pika 3, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, titulluar “Dispozita kalimtare për inspektorët me statusin e gjyqtarit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë”, është parashikuar se: “Inspektorët në detyrë, sipas këtij neni, që janë caktuar kryesisht për kryerjen e hetimeve disiplinore, vazhdojnë të ushtrojnë detyrën e inspektorit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe konsiderohen si të komanduar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në kohën e krijimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Me krijimin e tij, Këshilli i Lartë Gjyqësor realizoi një procedurë verifikimi dhe konfirmimi të statusit të magjistratit për inspektorët e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si dhe evidentimin e atyre inspektorëve që kishin qenë caktuar kryesisht për kryerjen e hetimeve disiplinore. Në kuadër të kësaj procedure, me vendimin nr.217, datë 22.10.2019, Këshilli ka vendosur:

“1. Të deklarojë pasjen e statusin “Magjistrat” për znj. Marsela Pepi.

2. Znj. Marsela Pepi të vijojë komandimin në detyrën e nëpunësit në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, deri në

krijimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Përmes shkresës nr.14 prot., datë 03.02.2020, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pasi njofton për krijimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kërkon informacion për komandimin e përkohshëm të inspektorëve magjistratë të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, sipas kërkesave të nenit 283, pika 10, të ligjit “Për organet qe qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Mbi sa më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor mbart detyrimin ligjor për të bërë komandimin e përkohshëm si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të magjistrates znj.Marsela Pepi, për një periudhë 6-mujore.

Mbi këtë bazë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për komandimin e përkohshëm si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të magjistrates znj.Marsela Pepi, ku në pikën 1 të tij përcaktohet pikërisht një gjë e tillë, sikundër dhe afati 6-mujor i komandimit të përkohshëm.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohen momenti i fillimit të efekteve juridike të vendimit, pikërisht nga data e njoftimit.

Më tej, në pikën 3 të projektvendimit, përcaktohet detyrimi i Këshillit për njoftimin e vendimit magjistrates znj.Marsela Pepi sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Pastaj, në pikën e fundit të projektvendimit, pikën 4, përcaktohet e drejta e ankimit ndaj vendimit, në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet edhe publikimi i tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, atëherë kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga Komisioni. Maks!

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

*Ilir Toska:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Pro.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Erjon Muharremaj:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Medi Bici:* Pro.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Komandimin e përkohshëm si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të magjistrates znj.Marsela Pepi, për një periudhë 6-mujore.

Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit.

Një kopje e vendimit i njoftohet magjistrates znj.Marsela Pepi sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbajtur, më 07.02.2020)*

***Pika 2 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:11 dhe mbaroi në orën 13:44.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi*** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 7. Ilir Toska*** (anëtar)
- 8. Alban Toro*** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj*** (anëtar)
- 10. Erjon Muharremaj*** (anëtar)
- 11. Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
5. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
6. *Gregor Borgowski, EURALIUS.*
7. *Anisa Kuçi, EURALIUS.*
8. *Valbona Bala, USAID.*
9. *Erion Fejzulla, USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjen e dytë të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me vijimin e diskutimit mbi shqyrtimin e projektvendimit “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, dhe ky akt i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ditën e djeshme në seancë plenare ne diskutuam lidhur me projekt-aktin. Duke qenë se anëtarët, për dy nenet e tij, kanë kërkuar opinion nga misioni i asistencës EURALIUS, atëherë u shty shqyrtimi dhe miratimi për ditën e sotme.

Nga ana e EURALIUS-it rezulton që të ketë dhënë opinion lidhur me dy nenet.

Për më shumë detaje ia jap fjalën zotit Ilir Toska.

*Ilir Toska:* Atëherë, opinionin ligjor i kërkuar nga misioni EURALIUS ka mbërritur për të dy çështjet që ne kishim kërkuar një opinion të tillë.

Anëtarët janë njohur me këtë opinion, kështu që mund të vazhdojmë diskutimet për projektvendimin.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kemi diskutime lidhur me përmbajtjen e rregullores?

**Ilir Toska:** Atëherë, po e marr unë fjalën meqenëse jashtë sallës plenare ne kemi vazhduar diskutimet dhe ka qenë kjo arsyeja që ne kërkuam opinion nga misioni EURALIUS.

Atëherë, diskutimi i parë lidhet me shkronjën /f/ të pikas 7 të projektvendimit dhe pikërisht për fjalinë “si dhe në çdo pozicion ku është komanduar me vendim të institucioneve të tjera, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, përpara ligjit për Statusin”. Fillimisht nuk ka qenë e përfshirë në projektvendim, në draftin fillestar. Mbas marrjes së opinionit nga disa magistratë, u konsiderua, ose unë konsiderova që të përfshihet në projektvendim edhe kjo fjali, pasi magistrati, ai që kishte ngritur shqetësimin, vlerësoi që duhet të ishte e përcaktuar shprehimisht edhe rrethana si më lart, me arsyetimin se mund të kishte interpretim të ndryshëm të rregullit të parashikuar në shkronjën /f/, sa i përket se kush do të konsiderohej përvojë në pozicionet e komanduara.

Mendoj që duhet të përfshihet në projektvendim edhe një reformë e tillë. Kjo aktualisht e për më tepër kur nga anëtarë të ndryshëm ka opinione që s’duhet të jetë. Pra vetë dispozita, drafti fillestar mund të interpretohej që ky rregull nuk shtrihet edhe për pozicionet e komanduara përpara ligjit për Statusin. Të njëjtin opinion për këtë i është kërkuar edhe opinion misionit EURALIUS. Misioni EURALIUS e ka dhënë këtë opinion në favor të përfshirjes shprehimisht edhe të kësaj dispozite. Mendoj se kjo është një gjë e drejtë dhe kushdo që ka patur pozicion të komanduar para ligjit të Statusit, ka dhënë kontribut për institucionet e sistemit të drejtësisë dhe sot ligji e konsideron këtë kontribut, e konsideron qoftë për efekte pozitive, siç është në rastin konkret, ashtu edhe për efekte negative.

Mund t’ju sjell në vëmendje, vetëm pak muaj më përpara, një nga magistratët që ka qenë i komanduar më herët, pra përpara ligjit të Statusit, ka dashur të marrë një mandat tjetër komandimi, dhe ne konsideruam që sa kohë nuk kishte bërë periudhën 5-vjeçare, pas komandimit të parë, nuk mund të merrte një komandim tjetër. Pra kemi pranuar që ligji i shtrin efektet edhe për komandimet e mëparshme. Kjo është një gjë e



drejtë dhe do duhet që ta shkruajmë shprehimisht, që asnjëri të mos konfundohet në të ardhmen për përfshirjen apo jo të pozicioneve të komandura më herët.

Sa i përket diskutimit tjetër, ishte ngërçi që kishim për magistratët që janë të komanduar, të paktën për vitin kalendarik të fundit, nëse ata janë në detyrë do duhet të bëjnë vlerësimin e përshpejtuar sipas rregullores së vlerësimit etik të gjyqtarëve, ndërkohë që nëse do të ishin të komanduar, kishte një boshllëk.

Kemi konsideruar që të përfshihet edhe një pikë për të zgjidhur këtë situatë. Dhe për këtë rregullim, misioni EURALIUS ka dhënë opinionin në favor të përfshirjes së këtij rregullimi. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Po, zonja Kadi!

**Brunilda Kadi:** Nga ana e Komisionit duhet të qartësohet, çfarë vjen si propozim nga shumica e Komisionit? Pra me përfshirjen e këtij sqarimi apo pa përfshirjen? Pra propozimi i Komisionit, si vjen?

**Alban Toro:** Atëherë, më duket se e sqaroi Iliri, që është propozimi i fundit që është bërë nga anëtari i Komisionit, jo nga shumica e Komisionit.

**Brunilda Kadi:** Pra shumica e Komisionit pa këtë sqarim.

**Alban Toro:** Shumica e Komisionit është për variantin e parë që nuk vlerëson që duhet të ketë fuqi prapavepruese për komandimin, pra si vlerë e shtuar për në vlerësimet e gjyqtarëve.

**Marçela Shehu:** Unë jam shumë dakord me Ilirin lidhur me pjesën që kontributi i të gjithë atyre që kanë qenë të komanduar është i rëndësishëm. Askush nuk e mohon kontributin që kanë dhënë të gjithë gjyqtarët që kanë qenë të komanduar në institucionet e tjera, po ashtu sikurse nuk mund të mohojmë kontributin që kanë dhënë gjyqtarët kudo ku ata kanë shërbyer në të gjithë vendin.

Ligji sot nuk e parashikon shprehimisht që ky ligj do të ketë fuqi prapavepruese lidhur me vlerën plus të komandimeve, përpara hyrjes në fuqi të ligjit.

Përfshirja e këtij përkufizimi apo e kësaj shtese në rregullore, unë mendoj që është një interpretim shumë i zgjeruar dhe jo i drejtë që ne i bëjmë ligjit. Në kohën kur këta gjyqtarë kanë qenë të komanduar, ligji nuk parashikonte që nëse ti komandohesh, atëherë

në momentin që ti do vlerësohesh apo do kërkosh të promovohesh, kjo do të jetë një vlerë plus. Nëse ligji do e parashikonte, mbase, jo vetëm këta gjyqtarë, por edhe shumë gjyqtarë të tjerë do të kishin përfituar nga kjo mundësi dhe mund të kishin kërkuar që të komandoheshin dhe të jepnin edhe ata kontributin e tyre, duke pasur edhe një lloj joshjeje pozitive për t'u komanduar, me qëllim që të vlerësoheshin dhe pse jo të promovoheshin në vonë.

Sot ligji e njeh. Dikur nuk e njihje. Kështu që unë mendoj që nuk ka vend për të dalë përtej ligjit, për të bërë jo interpretim, por për të dalë përtej ligjit.

Mendoj që nuk do të ishte e drejtë dhe e barabartë për të gjithë ata gjyqtarë që nuk kanë qenë të komanduar sepse rregullat e lojës nuk ishin të tilla në atë kohë.

Pra unë nuk mendoj që ne po i diskriminojmë në mënyrë negative ata gjyqtarë, por mendoj që ne do diskriminojmë negativisht ata gjyqtarë të cilëve nuk u është dhënë mundësia në atë kohë, që të komandoheshin, jo vetëm sepse nuk kanë kërkuar, por edhe sepse nuk ishte ky favorizim që ligji ia jep sot.

**Naureda Llagami:** Po, zonja Kadi!

**Brunilda Kadi:** Për të shtuar ato që u thanë nga Marçela.

Së pari, nisem nga ajo që sqaroi propozuesi, zoti Toska, që nuk ishte përfshirë fillimisht në draft, por më vonë nga një nga magjistratët, që ka drejtpërdrejt interes për këtë situatë, është propozuar që të vihet në rregullore dhe arsyetimi ishte që ligji nuk është i qartë. Pra ligji nuk e thënka. Vetë propozuesi e pranon që ligji nuk e thënka të paktën qartë. Pra minimumi edhe për këtë propozim ka diskutim.

Së dyti, unë kam qenë pjesë e grupit të punës në draftimin e ligjeve për reformën (si përfaqësuese e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë) dhe më kujtohet shumë mirë, dhe këtë e kam diskutuar edhe me kolegë që kemi qenë në grup pune dhe nuk besoj se e mohojnë edhe grupi që e propozon këtë përfshirje, arsyeja e vetme ndoshta – jo ndoshta, por unë jam e sigurt – që është vendosur ky diskriminim pozitiv për këtë lloj pozicioni, ka qenë arsyeja që gjatë gjithë kohës, deri në momentin që draftoheshin ligjet, ka pasur shumë probleme për rekrutimin e magjistratëve në inspektorat apo si ndihmësit ligjorë në Gjykatë të Lartë, dhe kjo u mendua si mekanizëm për të nxitur magjistratët që të vinin dhe të futeshin në këto skema (kjo dhe skema e delegimit, dy), që mendohej si një lloj

sakrifice për magistratin që të lërë vendin e tij të rehatshëm të punës (jo të rehatshëm), vendin e tij të përhershëm të punës, dhe të vinte dhe të bëheshe atë që e quajmë rëndom “flaj xhaxhis” (*fly judges*) dhe për t’i nxitur magistratët që të vinin në këtë skemë, u fut përsëri edhe skema e delegimit, një nga pozicionet që magistrati do kishte privilegje në momentin që do kërkoheshë promovimi.

Besoj që të gjithë biem dakord që ky ka qenë qëllimi i ligjit. Nuk ka fare sens logjik të mendosh që nxitja ka qenë për të shkuarën.

Tjetra është ajo që theksoi Marçela – është diskriminuese. Askush nuk është kundër që të jepen ca privilegje magistratëve që kanë qenë të komanduar – Po them pjesën e parë të mendimit, se kam edhe diçka tjetër për këtë – por kjo jo në kurriz të magistratëve të tjerë, sepse rregullat e lojës nuk vihen pasi mbaron loja dhe nuk bëhet fjalë që do t’i japin një shpërblim, por bëhet fjalë për karrierën e tyre. Dhe në qoftë se kandidon një magistrat që s’ka qenë i komanduar sepse nuk e ka ditur këtë rregull të lojës, me një magistrat të komanduar, ky i pari skualifikohet direkt dhe nuk ka mundësi të tregojë aftësitë e tij profesionale sepse hapat e mëtejshme që kanë të bëjnë me aftësinë profesionale, e thërrasin këtë kriter më vonë, që do të thotë, ai e ndalon garën që në fillim dhe është në kushte të pabarabarta.

Nuk e di nëse ndonjë nga juve mund të thotë një arsye pse një magistrat i komanduar duhet të ketë privilegj më shumë sesa një gjyqtar që ushtron ditë për ditë atë që duhet të bëjë një gjyqtar, të japë drejtësi, të ushtrojë veprimtari gjyqësore në gjykatë. Të gjithë ne e dimë situatën që kemi në Shqipëri që kemi më shumë se 80% të magistratëve që udhëtojnë dhe që bëjnë sakrifica deri në ekstrem me familjet e tyre që të vejnë të ushtrojnë detyrën e tyre në cepat më të largëta të Shqipërisë, edhe me shpenzimet e tyre që nuk janë kompensuar kurrë dhe vazhdojnë të mos kompensohen edhe sot dhe përsëri dalim në arsyetimin që e vetmja arsye që i është vënë ky privilegj është që të nxiteshin në të ardhmen, të vinin në skemën e delegimit.

Një argument më tepër, që propozuesi nuk e sjell për dy grupet e tjera është fakti që neni 48/9 pika /i/, ku rendit këto grup-magjistratët që privilegjojnë, thotë: “përvoja në pozicionet e komanduara” – është njëri grup, “magjistratët në skemë delegimi” – grupi tjetër, dhe “anëtari i Këshillit”.

Tani, nëse pranojmë që i vejmë rregulla mbas lojës këtyre pozicioneve të komanduara, a mund të më thoni, a ka logjikë pse mos t'i vejmë rregulla mbas lojës edhe magistratëve që kanë qenë de facto rrugëve të Shqipërisë, që gjykonin në të njëjtën ditë në tre rrethe gjyqësore dhe shkonin nga Fieri në Gjirokastrë apo nga Laçi në Dibër? Pse mos të kenë këta ca privilegje, por duhet t'i kenë këta të skemës së delegimit? Pikërisht kjo është logjika, që ky privilegj do fillojë të zbatohet me hyrjen në fuqi të rregullit të lojës, që ta dinë të gjithë dhe ta vlerësojnë të gjithë pastaj se cila është më e mira për ata. Edhe tjetra. Është anëtar i Këshillit, ku konkretisht unë po e interpretoj këtë në disfavor të interesit tim personal. Unë kam qenë anëtare e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Por sipas propozuesit, por edhe mendimit tim, këtu nuk përfshihet Këshilli i vjetër. Bëhet fjalë për Këshillin e ri e tutje. Dhe nuk mund të ketë pastaj diskriminim kaq haptazi, që për Këshillat nuk na kanë efekt Këshillat e mëparshëm; për skemën e delegimit nuk na paskan efekt skemat e delegimit; ndërsa për komandimet na paskan efekt.

Kështu që për mua, për të gjitha arsyet, nuk qëndron ky propozim.

Dhe një të fundit, për procedurë. Ne e shtymë këtë diskutim për t'i marrë mendim EURALIUS-it, por mendoj që ka një të metë shumë të madhe nga ana procedurale sepse ky propozim është bërë mbi bazën e një shqetësimi të një magistrati dhe ndërkohë nuk iu është vënë për dijeni të gjithë magistratëve të tjerë, që t'iu merret opinion gjyqtarëve të tjerë, që juve dakord jeni me këtë gjë, që të diskriminoheni? Kështu që, mendoj që nuk ka nevojë edhe të merret mendimi, por thjesht për të qenë transparent dhe për të treguar se çfarë ka ndodhur me procedurën, unë jam kundër shtimit të kësaj pjese që propozohet.

**Naureda Llagami:** Po, zoti Toska!

**Ilir Toska:** Atëherë, propozimi i magistratit konkret, që ju është bërë e ditur edhe juve ka qenë që të qartësohet dispozita. Nuk është ndonjë propozim i bërë rishtazi apo i ri. Ai ka menduar që mbase Këshilli do duhet ta qartësojë këtë dispozitë dhe unë mora iniciativën që të qartësohet dispozita, e para. E dyta, ligji nuk mohon asnjë kontribut të kaluar. Përkundrazi, ligji konsideron çdo kontribut të kaluar. Fakti që ligji pranoi sot, ka rivendosur atë që duhet ta kishte bërë në çdo kohë ligji edhe më herët. Fakti që kandidatët gjyqtarë sot në detyrë, nuk kanë qenë të komanduar, është një çështje e zgjedhjes së tyre. Pozicionet e komanduara kanë qenë të hapura për të gjithë. Dikush ka preferuar të lejë atë

dinjitetin/pushtetin e gjyqtarit dhe të vejë në pozicione që nuk preferohen as atëherë, as sot. Dhe kjo nuk mund të shumëzohet me zero sepse unë nuk kam bërë komandime më herët. Ai që e ka bërë...

**Brunilda Kadi:** Po e shumëzohet me 100 tani.

**Ilir Toska:** Të flas unë, duhet të më dëgjosh, siç të dëgjova unë. Mirë?

Në vijim të fjalës time... Dua të them që ligji, unë mora përsipër që të qartësoj këtë dispozitë vetëm për këtë kategori. Nëse zonja Kadi ka ndonjë propozim tjetër për kategoritë e tjera, mund ta bëjmë dhe ta diskutojmë. Fakti që nuk kam bërë propozim për të tjerat, mendoj se ligji është i qartë. Ligji, për të gjitha kriteret e renditjes ka konsideruar edhe të kaluarën. Se s'mund ta mohojë ligji dhe ta fillojë nga viti zero (nga viti 2016). Nëse mendoni që vetëm për komandimet është viti zero viti 2016, kjo është një çështje ta interpretosh ligjin në mënyrë të ngushtuar, në disfavor të kujtdo që ka dhënë kontribute në të gjithë të kaluarën e tij profesionale. Kjo është diskriminuese. Faleminderit!

**Brunilda Kadi:** Okej!

**Naureda Llagami:** Po, zonja Kadi!

**Brunilda Kadi:** E para njëherë, nuk është viti zero dhe nuk shumëzohen me zero. Thjesht të shumëzohen njëllor si të tjerët, që të jemi të ndershëm në atë që themi.

**Ilir Toska:** Ai që nuk ka kontribut...

**Brunilda Kadi:** Ja ta mbaroj, se edhe unë kur ju ndërpre...

Po pse gjyqtarët që gjykojnë nëpër rrethe kanë kontribut zero?

Çfarë kanë bërë ata?

**Ilir Toska:** Kontribute në pozicione të komanduara ju i shumëzoni me zero.

**Brunilda Kadi:** Pse duhet të ketë më shumë vlera ai në pozicion të komanduar?

**Ilir Toska:** Sepse ia ka dhënë ligji dhe duhet të ia kishte dhënë.

**Brunilda Kadi:** Jo! Ia ka dhënë në të ardhmen, nuk ia ka dhënë mbrapa.

**Ilir Toska:** Prandaj them viti zero dhe ju thoni viti zero është viti 2016.

**Brunilda Kadi:** Jeni duke cenuar parimin e rregullave të lojës që vendosen në fillim të lojës. Sepse ndoshta edhe një magjistrat që do ta dinte këtë gjë përpara, mund të hiqte dorë nga ai pushteti i gjyqtarit aty në Kukës, që të bëjë 4 orë rrugë vetëm vajtje. Të gjykojë 8 orë aty dhe të kthehet në mes të natës në shtëpi ose në Dibër, që kemi gjyqtarë

që shkojnë nga Maqedonia dhe, kjo puna e këtij gjyqtarit paska më pak vlerë se atij të komanduarit. Unë nuk e gjej dot logjikën këtu. Dhe ne me këtë gjë favorizojmë një numër dhe emra konkret magjistratësh, duke diskriminuar 95% të magjistratëve të tjerë. 95% e dhashë që të isha brenda, se mund të jetë edhe më shumë sepse lista e magjistratëve të komanduar para hyrjes në fuqi të ligjit, nuk besoj se i kalon 15 emra dhe nuk bëhet fjalë për të bërë “fer” (*fair*) me ligjin por bëhet fjalë për të mos qenë diskriminues ndaj shumicës së magjistratëve, që po ju vejmë rregulla loje, mbas lojës.

**Ilir Toska:** Këto nuk janë rregulla të reja loje.

S’ka mundësi ta interpretoni ju ligjin sepse ne duhet ta zbatojmë ligjin siç është i shkruar. Nëse ju doni t’i jepni një kuptim tjetër ligjit, është interpretim në kapërcim të ligjit. Duhet t’i diskriminoni këdo që ka kontribuar në këtë periudhë. Dhe ky është diskriminim. Dhe atë numrin që ka një listë mbrapa, e keni gabim. Se nuk di nëse ligjvënësi ka pasur parasysh ndonjë listë. Por ligjvënësi ka rivendosur atë që duhet të ishte në çdo kohë. Edhe atëherë ka qenë e hapur edhe sot, dhe kushdo ka kontribuar më herët, nuk e ka ditur që do vinte një ditë në vitin 2016 që ato kontribute do i njiheshin. Gjithsesi ai ka kontribuar. Dhe nëse doni t’ia mohoni, mohojani.

**Brunilda Kadi:** Po juve pse ia mohoni atyre që kanë qenë nëpër rrethe?

Pse ia mohoni?

Atë po i thua. Ty po të japë vlera më shumë që ke qenë këtu.

**Ilir Toska:** Ia ka dhënë ligji. Dhe nëse nuk do ta pranosh këtë, vazhdo.

**Brunilda Kadi:** Jo! Nuk ia ka dhënë ligji. Se po t’ia kishte dhënë ligji, zoti Toska, nuk do kishte nevojë që ta specifikonit në rregullore. Ju po dilni mbi ligjin në rregullore.

**Ilir Toska:** Unë propozoj që të specifikohet pikërisht për arsyen se ka disa që mendojnë ndryshe dhe kjo duhet të jetë e qartë për të gjithë. Nëse vendos kështu Këshilli, të gjithë duhet ta kuptojnë se kjo është ajo që Këshilli mendon dhe kam dashur ta shkruaj pikërisht edhe për këtë arsye.

**Naureda Llagami:** Zoti Muharremaj!

**Erjon Muharremaj:** Faleminderit!

Në përgjigje të pyetjes së hapur të drejtuar nga zonja Kadi, -“A mundet të më thotë dikush se pse duhet trajtuar si kontribut i veçantë qenia në një pozicion të

komanduar?”, - në gjykimin tim kjo ka të bëjë me rolin e gjyqtarit në një shoqëri.

Në gjykimin tim personal, roli i gjyqtarit në shoqërinë e sotme nuk është i kufizuar vetëm në dhënien e vendimeve për mosmarrëveshjet që i paraqiten atij përpara për të zgjidhur, por duhet të ketë një kontribut më të gjerë në shoqëri, edhe për të bërë publike veprimtarinë në komunitet apo për të dhënë kontributin pranë institucioneve të tjera, siç mund të jetë dhënia e kontributit për hartimin e projekt-akteve ligjore pranë Ministrisë së Drejtësisë apo mbrojtjen e interesave shtetëror pranë Avokatit të Shtetit apo çfarëdo lloj pozicioni tjetër që kërkohet kontributi i tij. Prandaj, fakti që ka lënë detyrën e gjyqtarit dhe ka ofruar veten për të dhënë kontributin e tij në pozicione të tilla, në gjykimin tim, duhet të vlerësohet.

Në lidhje me çështjen “po ta dinin këtë, do ta bënë edhe të tjerët”, - unë me informacionin që kam, pozicionet për komandim kanë qenë të hapura për të gjithë gjyqtarët, kështu që mundësinë për të konkurruar, për të dhënë kontributin e tyre në këto pozicione, e kanë patur të gjithë.

Referuar kësaj, unë shpreh votën time në favor të përfshirjes së këtij specifikimi në rregullore. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Muharremaj!

Edhe një herë, për procedurë tashmë.

Kemi më diskutime lidhur me propozimin e bërë nga zoti Toska në nenin konkret?

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

**Brunilda Kadi:** Meqenëse propozimi i zotit Toska është pakicë nga Komisioni, hidh në votim propozimin e zotit Toska, pra që të shtohet kjo gjë.

**Naureda Llagami:** Po! Dhe më pas kalojmë me propozimin dhe në tërësi të rregullores.

Diskutime të tjera për nene të tjera apo jo?

Okej! Atëherë kalojmë në votim propozimin e zotit Toska!

**Maksim Qoku:** Kundër.

**Brunilda Kadi:** Kundër.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Kundër.

**Fatmira Luli:** Kundër.

**Marçela Shehu:** Kundër.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Pro.

*(6 vota pro, 5 vota kundër.)*

Atëherë, miratohet propozimi i zotit Toska dhe kalojmë tani në miratimin e rregullores, sipas propozimit të bërë... miratimin e rregullores me gjithë propozimin e miratuar në nenin konkret nga zoti Toska. Kalojmë në votim rregulloren?

**Maksim Qoku:** Pro. Përveç klauzolës që votuam kundër.

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

**Naureda Llagami:** Atëherë, e hapim edhe një herë. Pra pranohet propozimi i zotit Toska. A ka propozime për nenet e tjera të rregullores dhe propozime konkrete?

**Brunilda Kadi:** Kam unë.

Në lidhje me kriteret pastaj se si ndahen magjistratët kur janë të dy të komanduar dhe dalin të dy të barabartë në vlerësim, kam një pyetje për draftuesit, për propozuesit. Ku u bazuan që kanë vënë si kriter kohëzgjatjen? Sepse ligji thotë “Këshillat vendosin kriteret në lidhje me komandime, pra sipas skemës së pikëve të përcaktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”. Ku u bazuat që kohëzgjatja duhet të jetë kriter dhe duhet të ketë më shumë pikë ai që zgjat më shumë në kohë?

**Ilir Toska:** Atëherë, ligji nuk thotë atë. Se hapi i parë është tek kriteri i parë. Është tek 14/a. Dhe në fakt, ligji ka thënë “kriteret për etikën dhe veprimtarinë profesionale nëpërmjet kandidatëve me pikë të barabarta vlerësimi”, që e thënë kështu bën pa sens sepse kriteret për etikën dhe veprimtarinë profesionale janë në ligj. Neni 14, pika /a/ ka dashur t’i japë Këshillit autorizim që të përcaktojë pikërisht kriterin...

**Brunilda Kadi:** E kam fjalën për pikën /c/.

**Ilir Toska:** Do më lësh të mbaroj?



14/a-ja është pikërisht për kriterin e parë që ka të bëjë me meritokracinë që është tek dy vlerësimet e mëparshme dhe pjesë e kësaj/këtij kriteri janë edhe përparësitë që ligji ka vendosur. Brenda këtij kriteri renditjeje, ligji ka autorizuar Këshillin që të vendosë përparësi. Qëllimi i ligjvënësit dhe i draftuesve, pra ne propozuesve është që filtri për të përzgjedhur kandidatin më të mirë, të bëhet sa më afër hapave, kritereve substancial që ligji përcakton. Pra brenda nivelit të parë ne të mundet të përzgjedhim kandidatin më të mirë pa vajtur tek kriteri i dytë i renditjes.

Këto kanë qenë arsyet që ne kemi konsideruar përparësi që të ndalojmë brenda kriterit të parë të renditjes, që të mos vejmë tek kriteret e mëpasshëm. Faleminderit!

**Brunilda Kadi:** Atëherë, unë s'jam dakord me këtë dhe propozoj që pika /c/ të hiqet si rend prioritar. Të hiqet fare. Të kalohet tek shumëllojshmëria.

**Ilir Toska:** Sa kohë... Më fal që e mora fjalën...

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

**Brunilda Kadi:** E propozoj dhe e votojmë. Ça lidhje ka tani.

**Ilir Toska:** A mund të diskutoj? Apo s'ka diskutime?

Është konsideruar kohëzgjatja se është pjesë e të njëjtës gjë që ligji konsideron. Sa kohë ligji konsideron pozicionet e komanduara “skemë delegimi” “anëtarë Këshilli”, kohëzgjatja ka diçka esenciale. Pra sa kohë konsideron pozicionin, do duhet të konsiderohet si përparësi kohëzgjatja. Kush ka kontribute me kohëzgjatje më të madhe, do duhet të ketë prioritet më shumë nga ai që ka kohëzgjatje më të shkurtër në një nga pozicionet që ligji konsideron si me përparësi.

Kjo ka qenë arsyeja që është vendosur si përparësi në këtë rast. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Keni propozim konkret zonja Kadi!

**Brunilda Kadi:** Ishte propozimi im që të hiqet pika /c/.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë në votim propozimin e bërë të zonjës Kadi?

**Maksim Qoku:** Kundër.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Kundër.

**Ilir Toska:** Kundër.

*Alban Toro:* Kundër.

*Fatmira Luli:* Kundër.

*Marçela Shehu:* Kundër.

*Erjon Muharremaj:* Kundër.

*Brikena Ukperaj:* Kundër.

*Medi Bici:* Kundër.

*Naureda Llagami:* Kundër.

Kemi më diskutime për ndonjë nen tjetër të rregullores?

Nëse jo, kalojmë në votimin në tërësi të rregullores?

*Maksim Qoku:* Pro. Përveç klauzolës që votova kundër.

*Brunilda Kadi:* Pro. Përveç asaj që tha edhe Maksi.

*Dritan Hallunaj:* Pro.

*Illir Toska:* Dakord.

*Alban Toro:* Pro. Përveç asaj shtesës që u propozua nga anëtari Toska.

*Fatmira Luli:* Pro.

*Marçela Shehu:* Pro. Përveç shtesës, që thanë edhe kolegët.

*Erjon Muharremaj:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Medi Bici:* Pro.

*Naureda Llagami:* Pro.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e vendimit “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, sipas propozimit të ardhur.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në fletoren zyrtare.

Shumë faleminderit!

Mbledhja është e mbyllur.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

---

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor  
Tiranë, më 07.02.2020 (Pika 2)***